

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“STAR BRANDS” SH.P.K

Me vullnetin tim të lirë, të shprehur edhe me nënshkrimin e këtij akt-themelimi në cilësinë e ortakut të vetëm, unë:

- Z. Hakif Gashi, shtetas Kosovar, lindur në Kosovë, më 01/04/1971, mbajtës i letërnjoftimit nr. P01377396 dhe numër personal 2001071877, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar;

krijoj sot më datë 27/11/2020 shoqërinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar “STAR BRANDS” SH.P.K me akt themelimi si vijon:

Akt Thmelimi i shoqërise tregtare “STAR BRANDS ” SH.P.K është i mbështetur në Kushtetutën dhe Kodin Civil në fuqi të Republikës së Shqipërisë, të Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar dhe të Ligjit Nr.9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

Neni 1
Forma dhe emri i shoqërisë

Krijohet shoqëria me përgjegjësi të kufizuar e quajtur “STAR BRANDS” SH.P.K dhe e identifikuar me shkurtimin e saj “SB”. Shoqëria do t’i nënshtrohet legjislacionit Shqiptar, ndërsa degët që mund të krijohen do t’i nënshtrohen legjislacionit ku do të ketë selinë dega. Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj në bazë të këtij akti themelues dhe statutit të shoqërisë që do të miratohet nga ortakët themelues.

Neni 2
Selia e Shoqërisë

Selia e shoqërisë “STAR BRANDS” SH.P.K do të jetë në: Rruga “Sami Frashëri”, Kulla Metropol, Kati i I, Tiranë, Shqipëri. Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, degë, të krijojë filiale si brenda ashtu dhe jashtë Republikës së Shqipërisë sipas parashikimeve të Statutit.

Neni 3
Objekti i Veprimtarisë

Objekti kryesor i Shoqërisë është:

- Tregtia me pakicë e bukës, ëmbëlsirave, produkteve prej mielli dhe produkteve prej sheqeri, në dyqane të specializuara;
- Tregtia me pakicë e mishit dhe produkteve të mishit në dyqane të specializuara;
- Tregtia me pakicë e pijeve në dyqane të specializuara;
- Tregtia me pakicë e produkteve të duhanit në dyqane të specializuara;
- Tregtia me pakicë e artikujve kozmetikë dhe të tualetit, në dyqane të specializuara;
- Tregtia me pakicë e frutave dhe perimeve në dyqane të specializuara;
- Tregtia me pakicë e veshjeve në dyqane të specializuara;
- Tregtia me pakicë të peshkut, krustaceve dhe molusqeve (frutave te detit) në dyqane të specializuara;
- Tregtia me pakicë e produkteve të tjera ushqimore në dyqane të specializuara;



- Tregtia me pakicë e tekstileve në dyqane të specializuara;
- Tregtia me pakicë e gazetave dhe materialit të shkrimit, në dyqane të specializuara;
- Tregtia me shumicë e luleve dhe bimëve;
- Tregtia me pakicë e luleve, bimëve, farërave, plehrave artificialë, kafshëve përkdhelëse dhe ushqimi i tyre, në dyqane të specializuara;
- Tregtia me shumicë e kafes, çajit, kakaos dhe erëzave;
- Tregtia me shumicë, jo e specializuar, e artikujve ushqimorë, pijeve dhe duhanit;
- Tregtia me shumicë e produkteve të qumështit, vezëve, vajrave dhe yndyrnave të gatimit;
- Tregtia me shumicë e sheqerit, e çokollatës dhe e ëmbëlsirave;
- Tregtia me shumicë e artikujve të tjerë ushqimorë, përfshirë peshkun, krustacet dhe molusqet (frutat e detit);
- Furnizimi me ushqim me porosi për raste;
- Tregtia me pakicë e mallrave të tjera të reja, në dyqane të specializuara;
- Tregtia me shumicë e mishit dhe produkteve të tij;
- Tregtia me shumicë e pijeve;
- Restorantet dhe aktivitetet shërbyese lëvizëse të ushqimit;
- Aktivitetet e tjera shërbyese të ushqimit;
- Aktivitetet e tjera shërbyese financiare, përveç fondit të sigurimit dhe atij pensional p.k.t
- Ndërmjetësimet e tjera monetare.

Shoqëria mund të kryejë me qëllim arritjen e objektivave të biznesit të shoqërisë, çdo veprim tregtar, industrial, financiar dhe transaksion në lidhje me pasuri të luajtshme e të paluajtshme të cilat janë të nevojshme ose të përshtatshme për arritjen e objektivave të Shoqërisë.

Objekti i Shoqërisë mund të ndryshohet me vendim të Asamblesë së Ortakut të Vetëm sipas kushteve për ndryshimin e Statutit.

Neni 4 Kohëzgjatja e Shoqërisë

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë pa afat. Ajo mund shpërbëhet në çdo kohë dhe për çfardo lloj shkak.

Neni 5 Kapitali i Shoqërisë

Shoqëria tregtare “STAR BRANDS” SH.P.K do të fillojë veprimtarinë e saj me një kapital themeltar prej 100 (njëqind) lekë.


Ky kapital përbën 1(një) kuotë me vlerë nominale 100 (njëqind) lekë

Neni 6 Drejtimi i Shoqërisë

Shoqëria do të drejtohet nga administratori i saj, Joriana Xamo, atësia Jorgji, shtetas Shqiptar, lindur më **13.06.1986**, në **TIRANË**, Shqipëri, banues në Tiranë, Shqipëri, mbajtës i letërnjoftimit ID me nr. **I65613060L**. Ai është përfaqësuesi i Shoqërisë në marrëdhënie me të tretët dhe ka kompetenca të plota në drejtimin e saj. Çdo kontratë do të kryhet prej tij dhe në rast mungese nga një përfaqësues i pajisur me prokurë të posaçme.



Specimenti i nënshkrimit:



**Neni 7
Të ardhurat**

Të ardhurat neto të shoqërisë i takojnë ortakut të vetëm të shoqërisë.

**Neni 8
Emërimet**

Ortaku themelues ka të drejtë të emërojë dhe administratorë të tjerë, ka të drejtë të caktojë financiarë, likuidator për problemet e shoqërisë si dhe të pajtojë persona të tjerë si ortakë.

**Neni 9
Zgjidhja e konflikteve**

Konfliktet që mund të lindin do të zgjidhen në zbatim të legjislacionit Shqipëtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**Neni 10
Vula e shoqërisë**


Shoqëria ka vulën e saj me madhësi të zakonshme, me tekstin rreth saj.

**Neni 11
Autorizimi për regjistrim**

Avokatet Av. Edlira Kapllani me Nr.Lic.4917 dhe Av. Lorena Këpucka me Nr.Lic. 8408, autorizohen këtu si përfaqësues të autorizuar për të vepruar individualisht ose bashkarisht për kryerjen e të gjithë procedurave të nevojshme për themelimin dhe regjistrimin e shoqërisë në Shqipëri, duke përfshirë por pa u kufizuar me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Bashkinë përkatëse, zyrat e taksave, zyrën e punës, zyrën e sigurimeve shoqërore dhe çdo autoritet tjetër publik sipas kërkesave të legjislacionit Shqiptar.

Akti i themelimit u përpilua në 2 (dy) kopje, për t'ju shpërndarë organeve kompetente dhe një kopje do të mbetet në dokumentacionin bazë të shoqërisë "STAR BRANDS" SH.P.K.

Akti i themelimit nënshkruhet rregullisht nga ortakut i vetëm të shoqërisë.



ORTAKU I VETËM THEMELUES

"STAR BRANDS" SH.P.K